



MANUAL PËRDORIMI



I nderuar Klient,

Jemi të sigurtë se do të mbeteni të kënaqur nga blerja e këtij produkti. Lutemi lexoni këto udhëzime plotësisht për të arritur rezultatin më të mirë nga produkti që keni blerë.

SHËNIME TË RËNDËSISHME:

- ☐ Duhet të ruani kuponin / faturën e blerjes së bashku me garancinë tuaj dhe t'ia bashkëngjisni çertifikatës së garancisë për të patur garanci të vlefshme.
- ☐ Për të shmangur rreziqet, kryejeni nëpërmjet një elektriçisti të autorizuar të gjithë përgatitjen në lidhje me instalimin e produktit dhe për ta përdorur produktin siç duhet dhe për të shmangur aksidentet, duhet të lexohen plotësisht udhëzimet e sigurisë.
- ☐ Ruajeni manualin e përdorimit në një vend ku munda ta gjeni lehtë.

Udhëzime mbi Sigurinë


- ☐ Aspiratorët për gatim në kuzhinë janë projektuar për përdorim të tipit shtëpiak gjatë gatimit. Ka rrezik prishjeje nëse përdoren për çdo qëllim tjetër dhe në rast të tillë nuk do të mbulohen nga garancia.
- ☐ Të gjitha instalimet elektrike duhet të bëhen nga një elektriçist i kualifikuar. Instalimi nga një person i paautorizuar mund të rezultojë në funksionim jo të mirë apo në dëmtim të produktit.
- ☐ Dalja e aspiratorit nuk mund të lidhet me daljet në të cilat nxirret tymi nga pajisje të tjera.
- ☐ Kur vihet në punë së bashku me pajisje të tjera që përdorin çdo lloj energjie përveç asaj elektrike, mund të dëmtojë funksionimin e këtyre pajisjeve (pasi konsumon ajrin në atë vend).

Shiko Figurën A:


- ☐ Në instalim aspiratorit duhet të jetë të paktën 65cm mbi sobat me gaz dhe të paktën 75cm mbi sobat që punojnë edhe me korent edhe me lëndë djegëse.
- ☐ Gjatë instalimit, kablli i furnizimit me korent nuk duhet të shtypet apo të pickohet.
- ☐ Nën këtë produkt nuk duhet të gatohen ushqime që marrin flakë.
- ☐ Nuk duhet të përdoren materiale filtrimi që nuk i rezistojnë zjarrit në vend të filtrit.
- ☐ Mos lini vaj të nxehtë në asnjë enë mbi sobë. Tigani me vaj të nxehtë mund të shkaktojë shpërthim vetvetiu.
- ☐ Lajini filtrat në kohën e duhur dhe në rastin e filtrave me karbon aktiv, zëvendësojini në kohë. Filtrat që nuk ndërrohen në kohën e duhur janë në rrezik zjarri për shkak të vajit që kanë mbledhur brenda.
- ☐ Nëse dëmtohet kablli i korentit, duhet të zëvendësohet nga personeli i autorizuar i servisit apo nga çdo ekspert tjetër i kualifikuar për të shmangur situata të rrezikshme.

Shënim: Nëse ndizet zjarr, fikni aspiratorin dhe pajisjen e gatimit. Mbuloni zjarrin. Mos përdorni kurrë ujë.

PREZANTIMI I ASPIRATORIT ME XHAM	PREZANTIM I ASPIRATORIT ME FILTRA TË DYFISHTË
1) Trupi prej Hekuri i Aspiratorit	1) Trupi i Aspiratorit
2) Çelësi i ndezjes së motorit	2) Çelësi i ndezjes së motorit
3) Pjesë e rrëshqitshme prej xhami	3) Pjesë e rrëshqitshme
4) Ndriçimi për gatim	4) Ndriçimi për gatim
5) Kaseta me filtër alumini për vajrat	5) Kaseta me filtër alumini për vajrat



Aspirator me Filtra të Dyfishtë
(FIGURA B)



Aspirator me Një Filtër
(FIGURA C)

Aksesorë Standartë

- Kompletet e Montimit	- Përshtatësin për nxjerrjen nga oxhaku
------------------------	---

Aksesorë Sipas Dëshirës

- Filtër Karboni Aktiv

Në vendet ku nuk ka oxhak, duhet të përdoren filtra prej karboni aktiv për të lëshuar ajrin në ambient pas filtrimit. Filtri i karbonit aktiv duhet të merret nga shitësi i autorizuar apo pika e autorizuar e servisit. Për të montuar filtrin e karbonit aktiv, në fillim hiqet kaseta e filtrit dhe instalohet filtri i karbonit aktiv në të njëjtën mënyrë në vend të tij.

Funksionet e Pajisjes

Aspiratori mund të përdoret në kuzhina me ose pa oxhak.

Për përdorim me oxhak

Dalja në oxhak realizohet duke lidhur një tub fleksibël të përkulshëm prej 100mm midis produktit dhe daljes së oxhikut.

KUJDES!

Dalja e aspiratorit nuk duhet të lidhet me gypat e ajrimit që përmbajnë tymin nga pajisje të tjera.

Për përdorim me oxhak (funksion riqarkullimi)

Ajri filtrohet nga një filtër karboni dhe rikthehet në ambient nëpërmjet një tubi me diametër 100mm ose oxhaku nga dollapi apo mbi të.

Kjo metodë përdoret në kuzhina pa oxhak ose në vende me oxhak, por që nuk janë të përshtatshme për instalim.

INSTALIMI

Nxjerrja e Pajisjes nga Paketimi:

Kontrolloni pajisjen për t'u siguruar se nuk ka ndonjë deformim. Çdo dëmtim i shkaktuar nga transportimi apo gjatë tij duhet t'i komunikohet menjëherë përgjegjësit për transportin. Për defektet e konstatuara gjithashtu duhet të njoftohet shitësi.

Mos i lini fëmijët të luajnë me materialet e paketimit.

Specifikat Teknike të Aspiratorit

	Motor i Dyfishtë
Tensioni:	220-240 V/50 Hz
Fuqia Motorike:	2x 95 W
Ndriçimi:	1 x 2 W
Fuqia Totale:	192 W
Rryma:	1,5 A
Nxjerrja e Ajrit:	120 MM
Mbrojtja Termike	120 °C
Shpejtësia e Rrjedhjes së Ajrit:	460 m3/h




FIGURA D: Diagrama e Lidhjes Elektrike

Vendi i Pajisjes

Kur të përfundojë instalimi, duhet të ketë largësi prej të paktën 65 cm midis produktit dhe sobave elektrike dhe të paktën 75 cm midis produktit dhe sobave që punojnë me lëndë djegëse. (Figura 3)




Figura 3
Pozicioni i Aspiratorit

Figura 4
Instalimi Brenda Dollapit nga Profili

LIDHJET ELEKTRIKE TË PAJISJES

Në pajisjen tuaj është futur një kabëll korenti i tokëzuar. Ky kabëll duhet të lidhet me një prizë të tokëzuar.

Gjatësia e kabllit të mbështjellë: 1,25 metra

Diagrama e lidhjeve elektrike për aspiratorin tuaj pasqyrohet në Figurën D.

Lidhjet elektrike të pajisjeve duhet të kryhen nga një elektrikist i kualifikuar.

INSTALIMI I PAJISJES

II-ASPIRATORËT

Pajisja juaj është instaluar në dollap siç pasqyrohet në Figurat E dhe F.

- 4 vrima shpohen në dërrasën prej druri poshtë dollapit, duke përdorur shabllonin e montimit.
- Produkti fiksohet në dollap duke përdorur 4x50 vidha, që cilat jepen së bashku me produktin.
- Kur të lëvizet pjesa rrëshqitëse, paneli i përparmë nuk duhet të prekë kapakun e dollapit.
- Duke përdorur këtë shabllon montimi në dërrasë prej druri, çahet një vrimë nxjerrjeje tymi më e madhe se 115 mm.




FIGURA E dhe F
PËRDORIMI I PRODUKTIT

Përzgjedhja e Shpejtësisë

Pajisja juaj përmban një motor me tre shpejtësi dhe një çelës me tre shpejtësi për ta kontrolluar atë. Për rezultatin më të mirë të mundshëm, ju rekomandojmë të përdorni shpejtësinë e lartë në një ambient të rënduar nga tymi i tepërt dhe era. Motori vihet në punë kur ndizet çelësi dhe ndalon kur ai fiket.

Produkti duhet të ndizet disa minuta para gatimit dhe të vazhdojë funksionimin derisa të largohen tymi dhe era nga ambienti.


Ndriçimi

Produkti ka llampa 2x25W dhe një çelës llampe për të komanduar ndriçimin. Që ndriçimi të funksionojë, çelësi i llampës duhet të jetë i ndezur.

Ajrim Efikas

Për të patur ajrimin e duhur, pjesa e brendshme e tubit që përdoret për oxhak duhet të jetë e lëmuar (si tubat PVC) dhe dritaret që hapen jashtë duhet të mbyllen. Dyert dhe dritaret drejt dhomave të tjera mund të qëndrojnë hapur.

Përdorimi i Çelësit të Kontrollit me Prekje



A	ON/OFF (Ndezje/Fikje)
B	Butoni i Uljes së Shpejtësisë
C	Ekrani
D	Butoni i Shtimit të Shpejtësisë
E	Rregullimi i Kohës
F	Butoni i Ndriçimit

Shënim i Rëndësishëm:

Kini kujdes kur pajisja vihet në punë së bashku me pajisjet që përdorin ajrin e ambientit njëkohësisht (p.sh. ngrohëse që funksionojnë me gaz, vajguri, qymyr apo dru, ngrohëse uji etj). Duke qenë se aspiratori nxjerr jashtë ajrin e ambientit, mund të ketë ndikim negativ mbi djegien.

Veproni konform rregullave dhe rregulloreve lidhur me zbrazjen e ajrit dalës, që janë shpallur nga institucionet e autorizuar. Ky paralajmërim nuk vlen për përdorimin pa oxhak.

Mirëmbajtja

Fikeni pajisjen para se të filloni çdo punë mirëmbajtjeje. (Hiqni kordonin nga priza).

Kaseta e Filtrit prej Alumini

Kaseta e filtrit prej alumini mbledh pluhurin dhe vajin që ka ajri. Filtri metalik duhet të lahet me ujë të nxehtë me sapun çdo muaj ose nëse është e mundur, në lavastovilje (60° C).

Heqja e Kasetës së Filtrit prej Alumini

- Hiqni Kasetën e filtrit prej alumini duke shtypur shqekëzat mbërthyes në anë.
- Mos e instaloni para se të thahet (Figura 7)

Filtri i Karbonit

- Filtri i karbonit largon erën që ka ajri.
- Në përdorim të zakonshëm duhet të zëvendësohet me një të ri në çdo 3 muaj.
- Mos e lani kurrë filtrin e karbonit. Për ta hequr atë nga vendi rrotullojeni në drejtim të kundërt nga ai i akrepave të orës.

Paralajmërim

Nëse nuk veproni sipas rregullave të pastrimit dhe të zëvendësimit lidhur me filtrat, mund të përfundojë me zjarr. Prandaj ju rekomandojmë të ndiqni rreptësisht udhëzimet e mëposhtme.

Pastrimi:

Sipërfaqet e jashtme të aspiratorit tuaj duhet të fshihen me një leckë të shpëlarë në detergjent të lëngshëm apo alkool. Mos përdorni kurrë produkte gërryese.

Detergjent për Pastrimin e Inoksit

Ekziston një produkt i veçantë për mbrojtjen e inoksit, i cili pastron gjurmët e gishtërinjve dhe shenjat mbi produkte dhe shmang ndryshkjen dhe efektet e tjera negative të ambientit për një kohë të gjatë.

Metoda e Përdorimit:

Detergjenti për inoks hidhet në një leckë të thatë dhe më pas fshihet inoksi në sipërfaqe dhe e gjithë sipërfaqja fshihet me këtë lëng. Pasi të prisni disa minuta, puna e pastrimit dhe e mirëmbajtjes përfundojnë duke fërkuar sipërfaqen me po të njëjtën leckë. Kështu mbi sipërfaqe krijohet një shtresë mbrojtëse. Ky aplikim duhet të bëhet periodikisht, pa pritur për shfaqjen e shenjave.

Paralajmërim:

Mund t'i shkaktojë alergji lëkurës. Shmangni kontaktin me lëkurën dhe sytë. Në rast kontakti me sytë, lajini me ujë të bollshëm dhe drejtojuni mjekut tuaj. Në rast kontakti me lëkurën, lajeni me sapunë dhe shumë ujë. Mos e përdorni për të pastruar akuariume, pasi mund të dëmtojë krijesat që jetojnë në akuarium.

Ruajeni larg fëmijëve.

Ruajeni në temperaturë dhome.

Zëvendësimi i elementëve ndriçues

- Fikni lidhjen e aspiratorit me korentin.
- Hiqni kasetën me filtrin prej alumini.
- Hiqni llampën difektoze dhe zëvendësojeni me një tjetër identike.

Probleme dhe Sugjerime për Zgjidhjet e tyre

Nëse pajisja juaj nuk funksionon:

Para se të thërrisni servisin:

Lutemi sigurohuni që pajisja është vënë në prizë dhe merr korent dhe se siguresa e instalimit elektrik është e rregullt. Mos u përpiqni të bëni asnjë veprim që mund të dëmtojë produktin. Para se të thërrisni servisin, kontrolloni pajisjen sipas Tabelës 1 më sipër. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni me shitësin tuaj apo pikën e autorizuar të servisit.

Servisi dhe pjesët e këmbimit:

Mund të merrni pjesët e këmbimit të produktit tuaj nga shitësi apo pika e autorizuar e servisit. Në paketim, së bashku me produktin përfshihet edhe lista e pikave të autorizuar të servisit. Kur të jeni në kontakt me shitësin tuaj apo me servisin e autorizuar, lutemi jepini numrin e produktit dhe emrin e modelit që lexoni në etiketën e produktit, për të kërkuar pjesët e këmbimit.

Mund të shikoni etiketën e produktit kur të hiqni kasetën me filtrin prej alumini.

	Kontrolloni lidhjen elektrike (Referojuni Udhëzimeve mbi Sigurinë, Pikës 2) (Tensioni i Rrjetit duhet të jetë 220 V dhe duhet të përdoret fishë e tokëzuar për Aspiratorin)	Kontrolloni çelësin e motorit (çelësi i motorit duhet të jetë në pozicionin e duhur)	Kontrolloni çelësin e llampës. Çelësi i llampës duhet të jetë në pozicionin e duhur)	Kontrolloni filtrin prej alumini (kaseta me filtrin prej alumini duhet të lahet një herë në muaj në kushte normale)	Kontrolloni llampat e dritave (llampat duhet të jenë të padjegura)	Kontrolloni tubin e daljes së ajrit (dalja e ajrit duhet të jetë e hapur)	Kontrolloni filtrin e karbonit (për ata që punojnë me filtër karboni). (Filtër i karbonit duhet të zëvendësohet në çdo tre muaj në kushte të zakonshme funksionimi)
Nuk punon aspiratori	X	X					
Nuk ndizet llampa ndriçuese	X		X		X		
Vakumi i ajrit të aspiratorit është i dobët				X		X	X
Nuk del ajër jashtë (në vendet pa tub dalës)				X			X

